REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 08/17
Datë/Datum. 15.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 08/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Ntsh Koslabor'' –Suharekë, kundër AK–/Qendra Klinike Universitare e Kosovës/, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur", me nr prok: "701/16/284/121", më datën 13.02.2017 mori këtë:

VENDIM

I. **Refuzohet,** si e pa bazuar ankesa e OE "Ntsh Kos Labor" - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur", me nr prok:"701/16/284/121", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Qendra Klinike Universitare e Kosovës/.

II. **I lejohet** autoritetit kontraktues /Qendra Klinike Universitare e Kosovës/, që të vazhdojë me procedurat e mëtutjeshme lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur", me nr prok: "701/16/284/121", konform dispozitave ligjore të prokurimit publik.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues Ntsh "Kos Labor" - Suharekë, i konfiskohet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është refuzuar si e pa bazuar.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:19.12.2016.

Data e fundit për dorëzimi të ofertave ka qenë:18.01.2017.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, kundër njoftimit për kontratë operatori ekonomik "Kos labor" - Suharekë me dt:04.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:05.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Kos labor" - Suharekë

I pakënaqur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim operatori ekonomik Ntsh "Kos Labor" - Suharekë, ka deponuar ankesë në OSHP, më 10 janar 2017 me nr. 08/17, kundër njoftimit për kontratë me titull: "Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur", me nr prok: 701/16/284/121, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues/teknike përmes raportit të datës 30 janar 2017, i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik të aprovohet e bazuar, ndërsa rekomandon që ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik siç parashihet me LPP, ose nëse autoriteti kontraktues e sheh të arsyeshme dhe nuk ka mundësi tjera atëherë të zhvilloj këtë aktivitet të prokurimit me procedurë të negociuar konform dispozitave ligjore të prokurimit publik. Ku parashihet që i takon autoritetit kontraktues dhe është kompetencë ekskluzive të vlerësojë nëse duhet të iniciohet një aktivitet i prokurimit me procedurë të negociuar.

Operatori ekonomik ankues "Ntsh Kos Labor" - Suharekë, me datë: 31 janar 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 03 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.02.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, ekspertet e OSHP-së, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Kos Labor" ka deklaruar: "Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe mbështesim raportin e ekspertizës së ekspertëve shqyrtues".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-QKUK ka deklaruar: "Ne përfaqësojmë QKUK dhe kolegjiumin. Aparati është sistem i mbyllur dhe kompanitë serioze të mëdha zakonisht certifikon firma të ndryshme për ti përfaqësuar më mënyrë më të mirë të mundshme dhe për të siguruar cilësi në punë të materialit shpenzues. Është interes i prodhuesit të mos bëhet me mëdyshje cilësia punës. Andaj ne kemi kërkuar që fituesi i mundshëm të jetë i certifikuar nga ajo kompani. Më herët dëgjova që ti mundësohet konkurrentëve tjerë të hyjnë në garë, dhe kjo konsideroj se nuk është mohuar përmes certifikatës pasi tenderi është i hapur, ndërkombëtar dhe drejt konkurrimi kanë gjitha kompanitë, jo vetëm kjo e certifikata nga Kosova por edhe ato të certifikuara nga rajoni. Potencialisht mund të jenë 5 apo gjatë kompanisë. Arsyeja e autorizimit është nga përvoja jonë, sepse prodhuesi është kontakt të drejtpërdrejt me përfaqësuesin dhe e informon poqë çdo linjë parregullsisë që mund të ndodh, ashtu prodhuesi informon distributorin e jo të tjerët, siç ka ndodh e do ndodhin në vazhdimësi. Pastaj distributori ka staf të specializuar për aplikim, që mund të jetë një kimist edhe që përgjigjet për kalibrimin, kontrollet dhe vijueshmërinë e rregullt punës dhe cilësinë e reagjentëve. Ofrojnë edhe shërbime me standarde të larta, dhe ruajtje profesionale materialit shpenzues. Jo siguron edhe mbrojtën e stafit tonë të punës për shkak të rrezikut që ne potencialisht mund të ballafaqohemi nëse ndonjë nga reagjentët mund të jetë me probleme-defekte dhe dihet fakti se ne me atë aparat do bëjmë analiza të ndjeshme infektive si HIV, hepatit etj, dhe nuk është e lehtë ti thuash diku je i infektuar me HIV e pas dy ditë ti themi jo nuk jeni , apo je me tumor dhe nuk je me tumor etj. Marr parasysh këto kemi menduar se kompania fituese duhet të ketë certifikatë të prodhuesit..

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi OE ankues deklaroj:"Pikat që potencoj AK stafi aplikimit, kompania që dërgon aparaturën gjegjëse në AK këtë rast qendra diagnostiko, ka për obligim me trajnua stafin për punë me aratim, pasi stafi trajnohet për punë me aparatin atëherë bëhet pranimi final. Kështu që është përgjegjësi e personelit pastaj me punu me aparatin dhe kjo nuk mund të hyj si kusht nëse nuk është marr vesh që aplikuesit të jenë gjithnjë aty në rast nevoje. Sa i përket shërbimeve cilësive të larta, AK më shumë jep raporte kontraktuale mes distributorit dhe prodhuesit. Ky është një ngatërrim. Nuk do thotë se nuk vlen aj kontroll veç për distributorin në Kosovë. Ai auditim vlen edhe distributorët e rajonit dhe kudo që i ka i njëjti prodhues, kështu ë edhe po te merren prej tij ata do informojnë për gjërat që potencon për një defekt në seri të reagencave ose diçka të tillë të mundshme. Sa i përket saktësisë , është punë e personelit dhe procedurave dhe në rast dyshimeve bëhen përsëritje testeve dhe jepet rezultati. Pastaj AK i referohet zinxhirit ruajtjes, përzihet në kompetenca të AKPM dhe secili OE është i mbikëqyrur dhe nuk mund të filloj punën pa plotësuar kushtet për pranim dhe ruajtje të reagensëve në këtë rast, kështu që ajo është kompetencë e dikujt tjetër. Un sa i përket procedurë nuk di është tender në kombëtar, mirëpo në Kosovë ka vetëm një të autorizuar të këtij prodhuesi konkret. Ne si kompani kemi qenë edhe për këtë prodhues të autorizuar më par, dhe dimë procedurat shumë mirë sa i përket kësaj natyre të prodhimit. Ne edhe sot kemi raporte me pohuesin Roshe dhe përfaqësojmë sektorin e diabetit, dhe prokurat për ruajtje, informim etj i dimë shumë mirë. Me këtë formë tenderimi shkelet neni 6 i LPP-së dhe neni 7 i LPP-së. Nëse kjo është tender i hapur, atëherë është veç për sy e faqe pasi vetëm një kompani në Kosovë do jetë fitues për këtë aktivitet, dhe si pasoj e mos konkurrencës do ketë çmime më të larta. AK duhet të heq kërkesën e autorizimit nga prodhuesi, dhe nëse insiston AK për autorizim atëherë të shkoj në procedurë të negociuar dhe do shihni se çfarë çmime do ofrohen. I propozojmë panelit të aprovoj ankesën dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja teknike deklaroj: "Qëndroj pranë raportit të ekspertizës". Pretendimi i OE ankues se analizatori Kobas E411 me sistem të mbyllur pranon vetëm reagjentët e prodhuesi Roshe Diagnostik, është i qëndrueshëm dhe kjo është pranuar edhe nga vet AK. Përfaqësuesi i AK ka deklaruar:"Kërkesa një është që fituesi të jetë i autorizuar nga prodhuesi, dhe prodhues është Rosh Diagnostik".Si profesionist mjekësor kërkoj që barra cilësisë së materialit shpenzues mos të bie në përgjegjësi time, por të bie në përgjegjësi të atij që fiton kontratën, përfaqësuesit të autorizuar, pasi kjo rrezikon punën time në vend. I propozojmë panelit të vërtetoj vendimin-dosjen tenderit për këtë aktivitet të prokurimit".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke pasur parasysh raportin e eksperteve të OSHP-së, si dhe prezantimet e dëshmive dhe të argumenteve në seancën dëgjimore konstaton se autoriteti kontraktues me të drejtë ka kërkuar që operatorët ekonomik duhet të kenë autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit pasi që pajisja për të cilën kërkohen reagensa është shumë e rëndësishme ku bëhen analiza të ndjeshme infektive si të hepatitit, virusit HIV etj, prandaj edhe operatori ekonomik i cili duhet të realizojë këtë kontratë domosdoshmërisht duhet të jetë serioz dhe të ketë autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar. Këtë e ka konfirmuar edhe Kolegjiumi Profesional i Klinikës së Biokimisë Mjekësore. Gjithashtu ky tender është i hapur dhe ndërkombëtar ku ju krijohet hapësirë të gjithë operatorëve ekonomik për të ofertuar, si operatorëve ekonomik vendor ashtu edhe atyre ndërkombëtare, prandaj nuk ka asnjë kufizim të konkurrencës dhe nuk ka trajtim jo të barabartë, siç ka pretenduar operatori ekonomik ankues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran MILENKOVIC

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"

1x1 OE – Ntsh "Kos Labor"- Suharekë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.